Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0264

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "A.L. DUSHI" SH.P.K., kundër njoftimit për dhënie të kontratës të "Spitali i Përgjithshëm-Pejë" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Pastrimi i Qarshafeve ne SP" me numër të prokurimit 70030-24-11622-2-2-1, me 03/06/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "A.L. DUSHI" SH.P.K. me nr. 2025/0264, e datës 11/04/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Pastrimi i Qarshafeve ne SP" me numër të prokurimit 70030-24-11622-2-2-1.

2. Anulohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të "Spitali i Përgjithshëm- Pejë", ndërkaq aktiviteti i prokurimit "Pastrimi i Qarshafeve ne SP" me numër të prokurimit 70030-24-11622-2-2-1 kthehet në **Rivlerësim.**

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik "A.L. DUSHI" SH.P.K.

5. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 10.11.2024, “Spitali i Përgjithshëm- Pejë” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Pastrimi i Qarshafeve ne SP” me nr. të prokurimit: 70030-24-11622-2-2-11. Ndërsa me datën 26.12.2024 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie te kontratës. OE “LAVOTEL SH.P.K.”

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 50,000.00 €.

Me 30.12.2025, OE “A.L. DUSHI” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 06.01.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim, ndërsa me datën 29.03.2025 OE ka ber kërkesë për rishqyrtim për te cilën nuk ka kthyer përgjigje.

Me 11/04/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “A.L. DUSHI” SH.P.K me nr. 2025/0264 për lidhur me aktivitetin “Pastrimi i Qarshafeve ne SP” me nr. të prokurimit: 70030-24-11622-2-2-1.

Me 22.05.2025, është caktuar paneli shqyrtues me autorizim për shqyrtimin e kësaj lënde.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Me dt.20.03.2025 paneli shqyrtues i OSHP -se ka marrë vendim për lëndën me nr. 2025/0043, “Pastrimi i Qarshafave në SP” me nr. të prokurimit: "70030-24-11622-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Spitali i Përgjithshëm- Pejë.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “A.L. DUSHI” SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

AK në vendimin e tij nuk i ka analizuar fare ofertën e OE A.L. DUSHIT për këtë aktivitet të prokurimit, duke u referuar se nuk ka përmbushur një kriter të përcaktuar të FDT, ashtu duke e shpallur të papërgjegjshëm edhe pse ka ofertuar më lirë.

AL DUSHI është lider në Kosovë në tregun privat dhe publik në shërbimet të cilat i ka kërkuar AK.

Në këtë drejtim OE A.L. DUSHI do të argumentoj si më poshtë:

PRETENDIMI ANKIMOR nr. 1: A.L. Dushi Sh.P.K. ka dorëzuar ofertë të përgjegjshme dhe më të lirë; Al Dushi ka pasur ofertë më të lirë në krahasim me kompaninë Lavonet i cili është rekomanduar për Kontratë. sipas Vendimit për eliminimin e A.L. DUSHI, nga AK – është theksuar se oferta e: “OE: A.L. DUSHI SH.P.K. nuk ë është në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimin për kontratë, sepse mungojnë dëshmitë se posedon Minimum 5 kabina për transportin e tekstilit në mënyrë higjenik kabinat (secila) të jetë me kapacitet minimum 100 kg, kabinat duhet të jenë të mbyllura dhe hixhenike, prandaj rekomandojmë të eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit si operator i papërgjegjshëm.”

Në lidhje me këtë pretendim , duhet theksuar se në ofertën e dorëzuar nga OE A.L. DUSHI SH.P.K., konkretisht në Listën e Pajisjeve, është deklaruar se Autoriteti Kontraktues (AK) do të ketë në dispozicion jo vetëm 5 kabina, siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit, por gjithsej 10 njësi, 10 kabina/box/rafte për çarçafët e papastër dhe 10 të tilla për çarçafët e pastër.

Për të dëshmuar këtë, OE ka bashkëngjitur fotografi të pajisjeve përkatëse, të cilat vërtetojnë se ato janë në disponim të menjëhershëm dhe plotësojnë kriteret teknike të përcaktuara nga AK. Gjithashtu, lista e makinerive është dorëzuar me tenderin.

Provë: Lista e Makinerive – dorëzuar me tenderin e Al Dushi

Nëse AK do të kishte ndonjë dyshim ose paqartësi rreth përputhshmërisë së pajisjeve të ofruara me specifikimet e tenderit, kishte mundësinë ligjore që, në përputhje me LPP-në, të kërkonte sqarime shtesë nga OE A.L. DUSHI SH.P.K. përpara se të merrte një vendim për eliminim. Kjo është në përputhje me parimin e transparencës dhe vlerësimit të drejtë të ofertave, që kërkohet me nenin 59 të LPP-s, megjithatë AK nuk ka kërkuar sqarime shtesë dhe kështu në mënyrë të kundërligjshme të e shpallte ofertën e papërgjegjshme.

PRETENDIMI ANKIMOR NR.2: - Vendimi për mos-përgjigjes të Kërkesës për Rishqyrtim është i kundërligjshëm pasi që lë në fuqi një vendim tjetër të kundërligjshëm Vendimi i AK për të refuzuar/mos trajtuar Kërkesën për Rishqyrtim të paraqitur nga OE A.L.DUSHI SH.P.K., tregon një tendencë të qartë për të lënë në fuqi një vendim të pabazuar ligjërisht për eliminimin e këtij operatori nga aktiviteti i prokurimit. Kjo është në shkelje të Nenit 108/A i cili kërkon dhe detyron që Autoriteti Kontraktues të lëshojë vendim më shkrim për trajtimin e kërkesave për rishqyrtim.

Me datë 25.03.2025, AK prap njofton se shpërblen me kontratë OE Lavotel SH.P.K.;,

Me datë 29.03.2025, OE A.L. Dushi paraqet Kërkesë për rishqyrtim tek AK lidhur me njoftimi për shërbimin e kontratën të Lavotel SH.P.K.

Edhe pse kanë kaluar më shumë se gjashtë (6) ditë, në kundërshtim me Nenin 108 (A) (tre ditë për vendim, me mundësi të zgjatjes edhe tri ditë shtesë), AK nuk ka lëshuar fare vendim. Vendimi për eliminim është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me dispozitat ligjore në fuqi, dhe në veçanti

(a) Bazohet në kritere të cilat janë të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe që janë përmbushur plotësisht nga OE A.L. DUSHI SH.P.K.

(b) Është marrë pa një vlerësim objektiv dhe të drejtë të dëshmive të paraqitura nga OE A.L. DUSHI SH.P.K. dhe (c) Është bërë pa analizuar në mënyrë të plotë ofertën e OE A.L. DUSHI SH.P.K.– e cila do të tregonte për përputhshmërinë e ofertë me kërkesat ligjore dhe dokumentacionin e tenderit.

Këto veprime përbëjnë shkelje të dispozitave të mëposhtme të LPP-së përkatësisht:

Neni 59, i cili kërkon që ofertat të vlerësohen në përputhje me kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit;

Neni 52 dhe Neni 60, të cilët sanksionojnë se për t'u shpërblyer me kontratë, një ofertë duhet të jetë e përgjegjshme dhe me çmimin më të ulët të vlefshëm.

Për më tepër, në këtë rast, Oferta e shpërblyer ka një çmim dukshëm më të lartë se ai i ofertës së paraqitur nga OE A.L. DUSHI SH.P.K.. OE A.L. DUSHI SH.P.K. ka përmbushur të gjitha kërkesat teknike dhe administrative të parashtruara në tender, duke e bërë ofertën e saj të përgjegjshme dhe për rrjedhojë të shpërblyeshme me kontratë.

Prandaj, refuzimi i kësaj oferte dhe shpërblimi i një oferte më të shtrenjtë dhe potencialisht të papërgjegjshme pasi që AK nuk ka dhënë qasje në dosjen e tenderit të OE të shpërblyer me Kontratë, përbën cenim të parimeve të transparencës, konkurrencës së ndershme dhe trajtimit të barabartë, siç përcaktohen në LPP.

PRETENDIMI ANKIMOR NR.3: - Autoriteti Kontraktues ka refuzuar të japë qasje në dokumentacionin e kompanisë së rekomanduar për Kontratë, e cila me shumë mundësi është e papërgjegjshme.

Në secilin rast, Autoriteti Kontraktues është në shkelje të Nenit 10 dhe 11 të LPP, kjo pasi ka refuzuar të japë qasje në dokumetacionin e kompanisë së rekomanduar për Kontratë. Kjo pasi ka dyshime serioze se kompania e tillë nuk e përmbushë kushtet e dosjes së tenderit.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "A.L. DUSHI" SH.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim Neni 59, paragrafi 4 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës ("Ligji Nr. 04/L-042"), ku përcaktohet se:* "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. [...]" Neni 60, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1. i Ligjit Nr. 04/L-042, ku përcaktohet se: "1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;" Neni 40, paragrafi 6 dhe 7 i Rregullores Nr. 01/2022 për Prokurimin Publik, ku përcakton se: "Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve" 40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur:

a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;

b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet

c. përcaktuara në dosje të tenderit;

c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.

40.7 "Në pajtueshmëri" nga aspekti administrativ dhe teknik duhet të kuptohet si përmbushje e kërkesave dhe e specifikimeve administrative dhe teknike të parashtruara në dosje të tenderit duke mos u larguar në mënyrë thelbësore nga ato dhe duke mos u bashkangjitur atyre kufizime. "Largime dhe kufizime thelbësore janë ato të cilat:

(i) Dallojnë esencialisht nga kushtet dhe specifikimet e dosjes së tenderit; dhe/ose

(ii) Afektojnë parametrat, cilësinë ose ekzekutimin e kontratës; dhe/ose

(iii) Kufizon të drejtat e AK ose obligimet e tenderuesit sipas kontratës; dhe/ose

(iv) Shtrembëron konkurrencën e tenderuesve, ofertimet e të cilëve janë në pajtueshmëri me rregullat." Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja

mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese. KËRKESA Sipas të lartcekurave, OE A.L. Dushi Sh.P.K., me respekt, kërkon nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të nxjerrë Vendim me të cilin: I. Aprovohet tërësisht si e bazuar ankesa e OE A.L. Dushi Sh.P.K., kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues Spitali i Përgjithshëm Pejë, ashtu që OE A.L. Dushi SH.P.K. të shpallet i përgjegjshëm dhe të shpërblehet me Kontratë.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: Operatori Ekonomik: "A.L. DUSHI" SH.P.K, KOSTA NOVAKOVIQ C4/2 LAM.B NR.5, Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim me datë 31.12.2024, kundër Njoftimit mbi VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Pastrimi i Qarshaeve ne SP"- Nr. i prokurimit: 70030-24-11622-2-2-1, duke pretenduar se janë bërë shkelje të dispozitave të LPP-së.

Autoriteti kontraktues: Spitali i Përgjithshëm- Pejë / Departamenti i Prokurimit, pas pranimit të kërkesës për RISHQYRTIM, ka bërë pezullimin e aktivitetit të prokurimit konform LPP-së. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet lidhur me pikat ankimore të OE:

Ankesa e Operatorit Ekonomik: "A.L. DUSHI" SH.P.K, KOSTA NOVAKOVIQ C4/2 LAM.B NR.5, Prishtinë, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore REFUZOHET si e BAZUAR dhe me këtë rast VERTETOHET Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, i datës: 26.12.2024.

Pretendimi ankimor i Operatorit Ekonomik: "A.L. DUSHI" SH.P.K, KOSTA NOVAKOVIQ C4/2 LAM.B NR.5, Prishtinë lidhur me:

Me 02.12.2024 kemi dorëzu tenderin për procesin e pastrimit në procedurën e prokurimit 70030- 24-11622-2-2-1. Sipas procesverbalit të hapjes së ofertave Kompania Jonë ka ofertu me çmim më te ultë.

Ne kemi ofertu me çmim 1.35/KG ndërsa OE LAVOTEL Shpk ka ofertu me 1.50/KG. Respektivisht, njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues-Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm i lëshuar nga AK më dt.26.12.2024 nuk mund të ketë efekt juridik dhe nuk mund te vazhdohet me nënshkrimin e kontratës sepse AK me mosveprimin në përputhje me Nenin 10, pika 3 dhe 5 të LPP ku parashihet që Autoriteti kontraktues do ti siguron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni ka bërë shkelje të LPP dhe obligimit që ka me Nenin 10 sepse AK nuk ka lejua casje në dokumentet e OE LAVOTEL, i cili në ofertim ka qenë më i shtrejt se ankuesi.

Parashtruesi i kërkesës OE ALDushi Shpk, me datën 26.12.2024 ka parashtrua kërkesën për casje në dokumenta të dosjes. Kërkesa është bërë përmes platformës e-prokurimi por e njëjta është dërgua edhe përmes emailit tek zyrtari i Prokurimit.

Edhe përkundër njoftimeve të bëra me shkrim edhe përmes telefonatës AK nuk ka dhënë asnjë përgjigje e as nuk ka dërgua asnjë njoftim lidhur me mundësinë e tërhjekjes së dosjes së kompanisë të cilës ju është dhënë kontrata për pastrim me njoftimin e datës 26.12.2024. Njoftimi i AK mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues-Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm i lëshuar nga AK më dt.26.12.2024 nuk mund të konsiderohet si vendim me efekt juridik sepse arsyetimi i dhënën në Vendim për tenderin e suksesshëm, respektivisht Vendimi për dhënie të kontratës tek LAVOTEL Shpk nuk është i verifikusheshëm nëse i njëjti OE ka përmbushë kërkesat e parapara me FDT e dosjes së tenderit gjatë procedurës së prokurimit 70030-24-11622-2-2-1, kjo si pasojë e mos përmbushjes së Nenit 10 të LPP nga

ana e AK.

Përgjigje në Pretendimin ankimor i Operatorit Ekonomik: “A.L. DUSHI" SH.P.K, KOSTA NOVAKOVIQ C4/2 LAM.B NR.5, Prishtinë:

Të nderuar Pretendimi i juaj ankimor nuk qëndron dhe është tërësisht i pabazuar, sepse AK- Spitali i përgjithshëm në Pejë, përkatësisht zyra e prokurimit ka qenë e hapur dhe bashkëpunuese me të gjitha palët e interesuar, në rastin tuaj ne ju kemi Ofruar qasjen në dokumente sipas LPP-së dhe për një gjë të tillë ju kemi informuar përmes sistemit të e- prokurimit me datë: 31.12.2024.

Po ashtu ju informoj ashtu siç edhe jeni njoftuar përmes letrës standarde për tenderuesin e eliminuar që Komisioni vlerësues ka konstatuar që oferta juaj është e papërgjegjshme sepse është ne përputhje me kërkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimin për kontrate, sepse mungojnë dëshmitë se posedon Minimum 5 kabina për transportin e tekstilit ne mënyrë higjenik kabinat (secila) te jete me kapacitet minimum 100 kg, kabinat duhet te jene te mbyllura dhe hixhenike, prandaj eliminohet nga ky aktivitet

I prokurimit si operator I papërgjegjshëm.

Ndërsa poashtu ju informoj që komisioni vlerësues ka konstatuar që Oferta e Operatorit ekonomik Ofertues “Lavotel” Sh.P.K, është në përputhje me kërkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimin për kontrate prandaj edhe shpallet fituese.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Autoriteti kontraktues: Spitali i Përgjithshëm- Pejë/ Departamenti i Prokurimit konform Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, dhe në KAPITULLIN IV Ankesat në procedurat e prokurimit të rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendim

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 15.04.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0264/2025, ndërsa me datë 12.05.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 0264/2025 me rekomandimet si në vijim: Bazuar në sqarimet e lartë përmendura, eksperti shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si Pjesërisht e Bazuar, të anulohet Njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në Rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk ka dhen përgjigje rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtuese, ndërsa OE pajtohet rreth raportit te ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertes, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit

si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "A.L. DUSHI" SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0264 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin nr.1

Pretendimi ankimor i OE ankues "A.L. DUSHI SH.P.K" , se nuk ka dorëzuar ofertë të përgjegjshme sipas AK, ky Pretendim është pjesërisht i bazuar, pasiqë OE ankues në Listën e e Pajisjeve të dorëzuar si pjesë përbërës të ofertës , i ka të cekura se i posedon 10 kabina/box//rafte për çarçafët e papastër dhe 10 të tjera për çarçafët e pastër të dëshmuara edhe me foto. Nëse për AK nuk kanë qenë të mjaftueshme këto dokumente dhe foto, atëherë bazuar në nenin 72 të LPP-së, AK është dashur të kërkoj sqarime shtesë, pasiqë oferta ka qenë me çmim më të ulët sipas kriterit të kërkuar në DT dhe në Njoftimin për kontratë.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues se AK nuk e ka zbatuar Nenin 108/A të LPP-se. Ky pretendim qëndron pasiqë AK nuk e ka trajtuar, shqyrtuar kërkesën për Rishqyrtim të parashtruar nga OE ankues. Çka nënkupton se nuk ka marrë asnjë vendim lidhur me këtë kërkesë për Rishqyrtim.

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Pretendimi ankimor i OE ankues se AK ka bërë shkelje të Nenit 10 dhe 11 të LPP duke refuzuar t'i jep qasje në dokumentacionin e kompanisë së rekomanduar për kontratë, Operatorit Ekonomik ankues. Ky pretendim ankimor qëndron, pasiqe AK nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik konkretisht nenin 10 të LPP lidhur me këtë aktivitet.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim për AK i cili obligohet të veproj në harmoni me rekomandimet e ekspertëve

shqyrtues.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim, dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin "Pastrimi i Qarshafeve ne SP" me nr. të prokurimit: 70030-24-11622-2-2-1. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues "A.L. DUSHI" SH.P.K dhe se argumentimi në raportin e ekspertes është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertes mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "A.L. DUSHI" SH.P.K janë pjesërisht të bazuara.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **Spitali i Pergjithshem- Pejë**
- OE - **A.L. DUSHI SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: